



R E P U B L I K A E K O S O V Ë S

/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO/

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË /OSNOVNI SUD U MITROVICI /BASIC COURT IN MITROVICA

C.nr. 209/2012

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditesve; dhe nga te cilet i perfaqson Avokat; nga sipas autorizimeve me shkrim, kunder te paditurve; dhe i nga tani me vendbanim te panjohur te cilet i perfaqson Perfaqsuessi i perkohshem, Avokat nga , sipas aktvendimit te kesaje gjykate , , baza e kontestit ; Vertetim pronesie, vlere e kontestit; 800,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.18.07.2013, jep kete;

**AKTGJYKIM**

**I- APROVOHET** kerkespadia e paditesve; dhe  
, dhe **VERTETOHET** me sa vijon;

-Paditesi; nga eshte shfrytzues i perhershem i palujtshmerise, pjeses se parc. kat. nr. ne vendin e qujtu " ", me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes ne sipërfaqe prej **150m2**, sipas qertifikates se pronesise ZK. e qe evidentohet ne emer te paditurit; 1/1.

-Paditesi; nga eshte pronar i palujtshmerise, pjeses se parc. kat. nr. , me kultur are e klases 2 , ne vendin e qujtu " ", me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes ne sipërfaqe prej **700m2**, sipas qertifikates se pronesise nr. ZK. e qe evidentohet ne emer te paditureve; 1/2, 1/2.

**II- DETYROHEN** te paditurit qe te iu njohin kete te drejte paditesve dhe te lejojne qe paditesit kete palujtshmeri ta regjistrojne ne emer te tyre prane Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne , ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

III- Detyrohen te paditurit qe ti kompenzojn solidarisht shpenzimet e Perfaqsesit te perkohshem; Avokatit nga , shumen prej 342,00 Euro ne afatin prej 15-diteve nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi nen kercnimin e egzekutimit te dhunshem..

### Arsyetim

Paditesit ne padit e tyre te parashtruara si dhe nepermjet te autorizuarit te tyre ne seancat e mbajtura kane theksuar se te njejtit ne vit 1970 i kane blere palujtshmerit kontestuese dhe qe nga momenti i shitblerjes paditesit sbashku me familjet e tyre kane hyre ne posedim te prones, ku te njejtit ne vazhdimesi e kane shfrytzuar pa asnje lloj kufizimi apo pengese. Paditesit tani vone kane kuptuar qe palujtshmeria e cila eshte ne posedim faktik te tyre qe nga blerja e saje nuk evidentohet ne emrin e tyre, andaj kane interes juridik qe kjo palujtshmeri edhe juridikisht te evidentohet ne emerin e tyre..

Pasi qe te paditurit jane ne adrese te panjohur i propozojne gjykates qe te njejteve te iu caktoj perfaqsesin e perkohshem.

I autorizuari i paditesve ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padite dhe precizimin e kerkespadive te paditesve ti aprovoi si te bazuara nga se paditesit kto palujtshmeri i kane fituar ne baze te shitblerjes dhe mbajtjes me mirbesim.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesve e konform nen 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK, gjykata me aktvendimin C. nr.209/2012 dt 20.06.2013 te paditureve iu caktoj Perfaqsesin e perkohshem, Avokat nga i cili ne baze te ketije aktvendimi do ti ushtron te drejtat dhe detyrimet, konform nen. 82.1.2 te LPK.

Perfaqsesi i perkohshem i te paditurit ne pergjigje te padive dhe precizimit te kerkespadive te paditesve ne fjalen perfundimtare i propozoj gjykates qe te sjell vendim ne baze te provave te administruara dhe ligjit.

Shpenzimet e perocedures kontestmore i kerkoj.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Certifikatat mbi pronesisin, nr. dt 25.04.2013,, njesia kat. , dhe , lexoi ekspertzen gjeodete te ekspertit gjeode, te dt.17.07.2013, beri veshtrimin ne Skicat e terenit, Procesverbalin mbi kqyrjen ne vend te kesaj gjykate C. Nr. 209/2012 dt 12.07.2013, ndegjoi deshmitaret; i, dhe si dhe ndegjoi paditesin . ne cilsu te pales dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Qertifikatat mbi te drejtat e pronese se palujtshme te cekur me larte konstatohet se parc. kat. tani lendore evidentohen ne emer te paditurve, sikurse qe eshte cekur ne dispozitiv te aktgjykimit.

Nga konstatimi dhe mendimi i eksperit gjeodet te cekur me larte konstatohet se ; pase matjeve te kryera te pjeseve kontestuese te palujtshmerive nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne , eshte vertetuar se palujtshmerite kontestuese bine -gjegjesishte e perbejne parc. te cekura me larte me masa dhe kufij te shenura si ne ekspertizat e dhena me shkrime dhe skicat e terenit te cilat jane pjese perberse te ketyre ekspertizave dhe te aprovura si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga Procesverbali mbi kqyrjen ne vend i kesaje gjykate i sipercekur konstatohet; se gjyqtari me vrojtim te drejperdrejt ne palujtshmerin kontestuese te paditesit;

eshte e ndertuar shtepia 2- katshe e banuar e rrethuar me mur dhe dyer te hyrjes te metalta.

Ne palujtshmerin kontestuese te paditesit; eshte e ndertuar shtepia perdhese e banuar e rrethuar me blloka betoni dhe dyer te hyrjes metalta.

Deshmitari deklaroi se vllau i tije tani paditesi ne vit. 1973 nga dhe i ka blere 7- ari me qmim 5-6 mi DM, sipas kontrates interne me shkrim ku i njeiti ka qene prezent me rastin e shitblerjes. Ne tersi e ka paguar qmimin e shitblerjes dhe menjeher ka hy ne shfrytzim te lire ku ne vit. 1983-84 e ka ndertu shtepin per banim ne te cilen ka jetuar pa pengesa dhe shfrytzuar gjermetani.

Deshmitari deklaroi; sipas njohurive qe ka diku ne vit 1983 nga dajt e tije e ka bler dhe ndertuar shtepin perdhese. Nuk ka qene prezent kur eshte bere shitblerja dhe se nga shitblerja gjermetani nuk ka ndonje mosmarrveshje. Keto rrethana i ka te njohura nga vllau i paditesit te cilin e ka shok dhe personalisht ka qene ne shtepi te

Deshmitari deklaroi; une e kame shok te ngusht dhe fqinje. Une ne ate vend jetoje qe 50 vite dhe i ka mbi 30 vite kur nga nje Serb ka bler diku 2- ari truall me qmim 4-5mi DM. Ne tersi e ka paguar qmimin e shitblerjes dhe menjeher ka hy ne shfrytzim te ketije trualliu dhe menjeher e ka ndertuar

shtepin 2- kateshe te cilen e shfrytzon nga ateher gjermetani pa kurfar pengese nga askush. Ka qene prezent kur eshte bere shitblerja dhe sa i kujtohet e kane perpiluar nje kontrat interne.

Paditesi deklaroj; ne Veren e vit. 1972 une ne cilsu te blersit nga shitesi kame blere truallin diku 2- ari me qmimte shitblerjes 5.000 DM, sipas Kontrates interne me shkrim te cilen e kemi nenshkrur une dhe shitesi tani i padituri, mirepo per fat te keq kjo kontrat si dhe shume dokumente tjera gjate Luftes i jane djegur sbashku me shtepine e cila ka qene e ndertuar ne te. Ne tersi e ka paguar qmimin e shitblerjes dhe menjeher ka hy ne shfrytzim te lire dhe e ka shfrytzuar pa pengesa gjermetani.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte, gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi se patundshmerin tani lendore paditesi; e ka blere nga shitesi, sipas kontrates interne me shkrim mbi shitblerjen qysh ne vit 1972 me qmim te shitblerjes prej 5.000 DM te cilin qmim ne tersi ia ka paguar shitesit i cili menjeher i ka lene ne disponim dhe shfrytzim te lire kete palujtshmeri- ne te cilen paditesi ka ndertuar shtepine 2- kateshe per banim te cilen e shfrytzon edhe tani pa kurfar pengese nga askush.

Paditesi palujtshmerin tani lendore e ka bler ne vit 1973 nga shitesit dhe sipas kontrates interne me qmim te shitblerjes 6.000 DM, te cilin qmim ne tersi ia ka paguar shitesve dhe menjeher ka hy ne shfrytzim dhe disponim te lire te kesaje palujtshmerie ne te cilen ne vit 1983-84 ka ndertuar shtepin perdhese per banim te cilen e shfrytzon edhe tani pa kurfar pengese nga askush.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronasin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr. O3/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne posedim te panderprer nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronasin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes, paditesit e kane pasur ne shfrytzim dhe disponim te lire keto palujtshmeri tani lendore dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditesve ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i papengushem i ketyre palujtshmerive.

Mbajtja me mirbesim ekziston se paditesit keto palujtshmeri i kane blere nga pronaret e tyre qka vertetohet nga fleta poseduse ne emer te paditurve.

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistn sepse paditesi e ka bler kete palujtshmeri ne vit. 1972, ndersa paditesi qysh ne vit 1973.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paditesit kane hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te ketyre palujtshmerive te tyre gjer me tani.

Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesve me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejttat te tjera sendore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nen. 453.2 te LPK, duke i njohur shpenzimet e Prfaqsesit te perkohshem per pjesmarrje ne 2-seanca shumen prej nga 171,00 Euro, nen. 7 te TA.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**  
C.nr.209/2012 dt 18.07.2013.

**Gjyqtari,**  
Ragip Kadriu.

**KESHILLE JURIDIKE;** Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine e permes kesaje gjykate.

*met hi probat  
Ref. per ble drit  
23.07.13  
Te se julehet ju jule 18.07.13  
me shprehur me M-E  
C.R. = GVE*

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE OSNOVNI SUD  
MITROVICA

Më  
Dana

*18.07.2013*

